REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 03/17
Datë/Datum. 27.01.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

AKT PËRCJELLËS

Për:	Menaxherit të Prokurimit: ***"Korporata Energjetike e Kosoves"***.	Kopje:	Paneli Shqyrtues - OSHP
Prej:	Visar BIBAJ - Ekspert shqyrtues Halil Hoti - Ekspert teknik		
Lënda:	Raporti lidhur me Ankesen e OE NTSH,***„Ekoinvest"***, - Prshtine nr. **03/17**.		
Datë:	**27.01.2017.**		

Bazuar në nenin 114 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 05/L-068, dhe Ligjin Nr. 05/L-092, për Prokurim Publik, ju njoftojmë me raportin e ekspertizës, lidhur me ankesen e parashtruara me dt. **06.01.2017**, me nr. **03/17**, nga OE NTSH **„Ekoinvest"**, me seli në Prshtine, kundër AK – **"Korporata Energjetike e Kosoves"**, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i sistemit gypor ne hinken e vatres se kalldajes bl.A3"**, me nr. të Prokurimit: **KEKC /16/113/511.**

AK, është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë kërkesë, të veprojë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.

Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues.

Ti dorëzohet:

- Autoritetit Kontraktues - **"Korporata Energjetike e Kosoves".**
- Panelit Shqyrtues - **"OSHP".**
- OE - ankues - "NTSH **„Ekoinvest",- Prishtinë.**

REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT/ TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI/
PROCUREMENT REVIEW BODY

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES - TEKNIK

		16.01.2017		**20.01.2017**		**27.01.2017**
Nënshkrimi i ekspertit		*Data e autorizimit të eksp.*		*Data e fillimit të ekspertizës*		*Data e dorëzimit të raportit*

N. 105, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit

Me datën **06.01.2017**, Organi Shqyrtues i Prokurimit ka pranuar ankesën me nr. **03/17**, e parashtruar nga OE NTSH**„Ekoinvest"**, me seli në Prshtine, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i sistemit gypor ne hinken e vatres se kalldajes bl.A3"**, me nr. të Prokurimit: **KEKC /16/113/511**, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues – Korporata Energjetike e Kosoves.
Konform nenit 113.1 të Ligjit Nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr.05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092. Eksperti Shqyrtues - teknik e ka shqyrtuar dhe analizuar lëndën e (AK) –**Korporata Energjetike e Kosoves.**

N.111,LPP - Operatori Ekonomik Ankues NTSH**„Ekoinvest"**, me seli në Prshtine.

Pikat e Ankesës nga OE NTSH**„Ekoinvest"**, me seli në Prshtine, *dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues:*
Neni – 8 i UOPP -së
Neni – 22 i LPP-së
Neni –59 i LPP-së
Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:
Duke ju referuar njoftimit te dërguar nga AK KEK me date 27.12.2016, ne ndërlidhje me anulimin e aktivitetit te prokurimit, KEKC-16-113-511 "Riparimi i sistemit gypor ne hinken e vatrës se kaldajes bl.A3 ", për te cilin jane thirrur ne neni 8.7 te UOPP-se, i cili thekson se:
"8.7 Personat që kane autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para nënshkrimit të kontratës me tenderuesin fitues, të ri-konfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk kanë ndryshuar në mënyrë substanciale"

Deshmia 1: email 16.12.2016
Atëherë bazuar ne nenin e lartcekur 8.7 komisioni i vlerësimit nuk është autoritet i cili mund te vendose lidhur me disponueshmerinë e mjeteve financiare, dhe nuk ka te drejte te rekomandoje anulim projekti për shkak te ndryshimeve substanciale ne buxhet.
Duhet theksuar se AK KEK me rastin e inicirnit te këtij projekti i ka përfunduar te gjitha obligirnet sipas nenit *8 te UOPP-së — Deklarata e nevojave dhe përcaktimi i disponueshmerise se fondeve,* pasi qe vete fakt qe është inicivar aktiviteti i prokurimit nënkupton që është plotësuar ne plotni nen 8. Rrjedhimisht pratendim i AK bazuar ne nenit 8.7 nuk qëndron.
Gjithashtu anulimi I këtij aktiviteti te prokurimit është bere ne kundërshtim te plote me nenin 22, te LPP. Akti i anulimit te këtij aktiviteti te prokurimit është i pabaznar dhe kundërshtim te plote me nenin 22 paragrafi 1 te LPP sepse nëse i referoherni nenit ne fjale, asnje aktivitet i prokurimit nuk mund te inicohet pa mbështetje financiare dhe pa aprovim te ZKA paraprakisht.

Për informimin tuaj, ky projekt është inicinar ne 24.02.2016, *(Deshmia 2 — njoftimi për kontrate)* që ka qene kohe mese e mjaftueshme për perfundimin e këtij aktiviteti te prokurimit, Gjithashtu edhe vendimi I OSHP-së i datës 08.07.2016 psh. nr. 132/16/ *(Dëshmia 3),* vendim i cili është i prere dhe kundër të cilit rnund te ankohet vetëm ne gjykatën themelore në Prishtinë, kane kaluar me tepër se 5 muaj. Po te respektoheshin afatet kohore sipas ligjit, edhe vete projekti do te realizobej pasi qe afati i implementimit ka qene 60 dite.
Andaj konstatojrnë se arsyetimet e AK KEK për anulimin e projektit si rezultat i ndryshimeve substanciale ne buxhet, janë te paqëndrueshme, rrjedhimisht ne baze te lartcekurave janë anti ligjore.
Edhe ne vendimin e rishqyrtimit te datës 08.11.2016, *(Deshmia 4 — vendimi per rishqyrtim)* te lëshuar nga AK KEK, vendoset qarte se pretendimet tona janë te bazuara, dhe se vendimi i AK për anulim është i pa baze, qe nga kjo date ka pasur mjaft dite ne dispozicion per te na shpallur si OE te suksesshem.
Kjo diskrepance e vendimeve ndodhe vetëm me ne (EKOINVEST) dhe me AK KEK. Fillimisht nuk respektohet asnjë dispozite ligjore te cilat i përcaktojnë afatet kohore sipas LPP-se dhe UOPP-se, gjithashtu as vendimi i prere i OSHP-se. Nga te gjitha pika e lartshënuara shihet qarte se nuk janë respektuar dispozitat ligjore te LPP-se dhe UOPP-se.
I propozojmë panelit shqyrtues, qe nga faktet e sipër theksuara dhe te dëshmuara me prova materiale i propozojmë panelit shqyrtues qe ankesën tone ta pranoj si te bazuar dhe te anuloje vendimin e AK KEK- për anulimin e aktivitet.
Demet material:
Tani per tani te papercaktuara.

Procesi i prokurimit:

Data e njoftimit për kontratë në KRPP :	23.02.2016
Lloji i procedurës së aplikuar:	Procedurë e hapur
Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar:	Punë/vlerë e madhe
Afati i fundit për dorëzimin e ofertave (gjithsejtë ditë):	04.04.2016
Data e hapjes së ofertave	04.04.2016
Njoftimi për anulim te AP-se ne krpp	01.11.2016

Kriteret për vlerësim

III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:

Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale te parashtruara

1. Operatori ekonomik duhet te përmbush kërkesat mbi përshtatshmërinë të Ligjit Nr. 04/L-042 Neni 65.
2. Një vërtetim i nënshkruar nga administrata tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit.- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.
3. Një dokument lëshuar nga Gjykata kompetente që vërteton se operatori ekonomik i përmbush "Kërkesat e pershtatshmerise" Pika III.1.1.) 2.a,c,d dhe e. – origjinal ose kopje e noterizuar .- kërkohet vetëm për fituesin e tenderit.

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një deklarata nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërise, pika 2 dhe 3, do të kërkohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit te këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet

III.2.2 Përshtatshmëria profesionale

Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë kërkesat minimale te parashtruara

1. Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit;
2. Regjistrimi i TVSH;
3. Regjistrimi i numrit fiskal

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një dokument i lëshuar nga autoriteti përkatës publik në vendin e themelimit të operatorit ekonomik me të cilin evidentohet regjistrimi i operatorit ekonomik në atë vend (Kopja e certifikatës së biznesit);
2. Kopja e regjistrimit per TVSH-ne;
3. Kopja e regjistrimit te numrit fiskal.

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar N/A

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

Operatorët ekonomik duhet ti plotësojnë këto kërkesa mbi mundësitë teknike dhe/apo profesionale

1. Projektet e realizuara brenda 3 viteve te fundit
2. Katalog,mostra, përshkrime, fotografi
3. Përshtatja me specifikat ose standardet

Dëshmia e kërkuar dokumentare:

1. Një listë që specifikon secilin nga projektet të kryera nga OE në 3 vitet e fundit (2013,2014,2015) . Se paku 1 (nje) reference ne realizimin e projekteve të ngjashme të përfunduara në 3 vjetët e fundit. Te dëshmohet me reference të lëshuar nga punëdhënësi për kryerjen me sukses te projektit.
2. Përshkrime teknike ose katalogë ose vizatime te prodhuesit për materialet që do të liferohen.

Kopjet e ISO certifikatave te prodhueseve për materialet qe liferohen.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr	Operatoret ekonomik	Vendi	Çmimi total për njësi €	Vërejtje
1.	"Ekoinvest"	Prishtinë	470,334.99 €	JO
2.	"Inter Ing"	Prishtine	465,144.20 €	JO
3.	"Ar - Tech"	Prishtine	507,048.11 €	JO

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve me datën: 04.04.2015, *konstatohet se në hapjen e ofertave ka marrë pjesë tre(4) përfaqësues të OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi, çmimi dhe ndonjë vërejtje nëse është paraqitur. Procesverbali i hapjes është nënshkruar nga anëtarët e komisionit të hapjes pranë AK-së.*

Komisioni vlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për vlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Ardian Hasani
- - Anëtar i komisionit - Fadil Rashica
- - Anëtar i komisionit – Mustafa Kavaja

Data e mbarimit të vlerësimit: 06.04.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....10.04.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas vleresimeve te detajizuara te Ofertave te OE-ve, per tenderin NDERTIMI I SISTEMIT GYPOR NE HINKEN E VATRES SE KALDAJES BL.A3, komisioni propozon te anulohet ky aktivitet, ne mungese te ofertave te pergjegjeshme.

Komisioni rivlerësues pranë AK:

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues.

Autoriteti Kontraktues për rivlerësimin e tenderëve ka caktuar komisionin në përbërje prej tre anëtarëve, si në vijim:

- - Kryetar i komisionit – Tefik Krasniqi
- - Anëtar i komisionit - Sabri Simnica
- - Anëtar i komisionit – Emin Tmava

Data e mbarimit të vlerësimit: 13.12.2016

Data e nënshkrimit te raportit nga zyrtari kryesor i prokurimit:.....15.12.2016

Raporti i komisionit vlerësues:

Pas vleresimeve te detajizuara te Ofertave te OE-ve, per tenderin NDERTIMI I SISTEMIT GYPOR NE HINKEN E VATRES SE KALDAJES BL.A3, komisioni me shumice votash propozon te anulohet ky aktivitet, ne mungese te ofertave te pergjegjeshme.

Njeherit ky aktivitet i prokurimit edhe per shkak se njesia e kerkeses per vitin 2017, nuk ka parapare buxhet per kete aktivitet te prokurimit pra arsye tjeter e anulimit eshte mungesa e buxhetit per kete tender.

Lidhur me kete pike te anulimit rekomandimi i komisionit eshte unanim.

Aaliza dhe sqarimet e ekspertit shqyrtues - teknik (N. 113, 114)

Eksperti shqyrtues - teknik pas ekzaminimit të dosjes së tenderit, shqyrtimit të rrjedhës së procedurës së tenderimit dhe pretendimeve të palës në ankesë sqaron me sa vijon

Sqarimi 1

Autoriteti Kontraktues - **"Korporata Energjetike e Kosoves"**, gjatë këtij aktiviteti të prokurimit ka zbatuar procedurë të hapur, lloji i kontratës është punë, kontratë publike me vlerë të madhe, operatori ekonomik ankues: NTSH **"Ekoinvest"**, ka parashtruar ankesë në këtë aktivitet të prokurimit kundër njoftimit per anulim te aktivitetit te prokurimit.

Fillimisht sqarojmë se OE, tanime ankues edhe më daten. 12.05.2016, kishte parashtruar ankesë, poashtu kundër anulimit të këtijë aktiviteti të prokurimit, ndërsa OSHP - Paneli shqyrtues përmes vendimit të datës 23.06.2016, konkretisht përmes pikës nr. –I-, të dispozitivit kishte aprovuar ankesën e OE NTSH "Ekoinvest", si të bazuar, ndersa pika –II-, e të njejtit vendim kishte kthyer lëndën në rivlerësim.

Sqarimi 2

Pas ri-vlerësimit të ofertave AK – KEK, më datën 31.10.2016, njofton parashtruesin e ankeses përmes letrës standarde se i njejti është eleminuar, duke dhënë arsyetimin. Kundër njoftimit për eleminim OE "Ekoinvest", më datën 01.11.2016, kishte parashtruar kërkesë për rishqyrtim me pretendimet ankimroe se ishte bërë shkelje e nenit , 7, 28 dhe nenit 59, të LPP-së. AK – KEK, më datën 08.11.2016, nxjerr vendim dhe aprovon si pjesërisht të bazuar kërkesën ndërsa lëndën e kishte kthyer në ri-vleresim. Pas rivleresimit të ofertave komisioni rivleresues përseri kishte rekomanduar anulimin e aktivitetit të prokurimit, ndërsa më datën 16.12.2016, parashtruesi i ankeses është njoftuar përmes shkresës elektronike (e-mailit), me arsyetimin e anulimit.

Kundër të njejtit anulim, parashtruesi i ankesës më datën 21.12.2016, parashtron përsëri kërkesë për rishqyrtim, duke pretenduar se AK, me rastin e anulimit të këtijë aktiviteti të prokurimit, ka bërë shkelje të nenit, 8, të UOPP-së, si dhe nenit 59, të LPP-së. AK–KEK, kundrejt të njejtës kërkesë më datën 27.12.2016, nxjerr vendim dhe refuzonsi si të pa bazuar kërkesën me arsyetimin se: "*AK me rastin e anulimit të aktivitetit të prokurimit ka vepruar konform UOPP-se, të LPP-së nr. 04/L-042, përkatësisht nenit 7. 8, si dhe nenit 8.7, të UOPP-së, të ligjit nr. 04/L-042 për PP të RKS-së i ndryshuar dhe plotesuar me ligjin nr. 04/L-237, ligjin nr. 05/L-068 dhe ligjin nr. 05/L-092 ku citohet: "Personat që kanë autoritet të nënshkruajnë kontratat janë të obliguar, para nënshkrimit të kontratës me tenderuesin fitues, të rikonfirmojnë që informatat financiare (DNPDF) nuk ka ndryshuar në mënyrë substanciale. Anulimi është bërë pasiqë informatat financiare kanë ndryshuar në mënyrë substanciale, AK (njësia kërkuese) nuk ka paraparë buxhet për vitin 2017, për këtë projekt*".

- Arsyetimin e lartë përmendur të anulimit të këtijë aktiviteti të prokurimit e kualifikojmë si të pa bazuar pasi që për këtë aktivitet të prokurimit, AK – KEK, sipas kopjes së deklaratës dhe vlerën e planifikuar për kwtw aktivitet tw prokurimit prej **600,000.00 €.** Rrjedhimishtë asryetimi si i tillë bie ndesh me nenin **22**, par 1, të LPP-së. Për më tepër anulimi i aktivitetit të prokurimit në këtë fazë paraqet mos respektim të nenit **62,** të LPP-së në fuqi, pasi që paragrafi **2**, nënparagrafi **2.2,** i të njejtit nenë shprehimishtë thotë: "***Para hapjes së tenderëve, ndërprerja e aktivitetit të prokurimit është bërë e nevojshme për shkak të ngjarjeve objektive dhe që mund të demonstrohen dhe/ose arsyeve që janë jashtë kontrollit të autoritetit kontraktues dhe që nuk mund të parashikohen në kohën e inicimit të aktivitetit të prokurimit por kjo duhet të bëhet së paku tre (3) ditë para hapjes së tenderëve***".

Mendimi i ekspertit shqyrtues - teknik:

- Eksperti shqyrtues - teknik bazuar në sqarimet e cekura në raport rekomandojnw panelin shqyrtues qw aktiviteti i prokurimit me titull: "**Riparimi i sistemit gypor ne hinken e vatres se kalldajes bl.A3**", me nr. të Prokurimit: **KEKC /16/113/511**, të kthehet në **Ri-vleresim**, ndwrsa ankesa e operatorit ekonomik NTSH **"Ekoinvest"**, të aprovohet si e **bazuar.**